



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.478/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat: e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dhe Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitura kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHEN TË BAZUARA ankesat: Anr.478/2025 e parashtruar nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, me seli në Prishtinë, dhe Anr.486/2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në Prishtinë, të datës 09.02.2025.

II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2,000.00€euro (dymijë) €euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 09.02.2025 ka pranuar ankesat: Anr.478/2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dhe Anr.486/2025 e parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitura kundër Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë.

-Në ankesën An.478-2025 Subjekti Politik PDK pretendohet se më datë 07 shkurt 2025, në vendvotimin nr. 03/02, në shtetin e Zvicrrës, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, pas hapjes së këtij vendvotimi janë paraqitur në vendvotimin e lartcekur me bluzë me mbishkrimin "LËVIZJA VETËVENDOSJE", duke ndikuar qëllimisht tek votuesit përmes shfaqjes së emrit

të këtij subjekti politik dhe në këtë mënyrë ka cenuar rëndë dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në ankesën Anr.486/2025 Subjekti politik LDK ushtron ankesë kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, te cilën ia përcjell PZAP-se si organ kompetent dhe i autorizuar.

LDK Dega ne Zurich ka vërejtur se me rastin e mbajtjes se ditës se zgjedhjeve — votmit ne mërgate, ne konsullatën e Zurichut, vëzhguesit e LVV kane bartur material zgjedhore me emër te subjektit politik, duke shkelur kësisoj nenin 37 te LZP si dhe nenin 8 paragrafi 1, nen paragrafi 1.2 te Rregullores zgjedhore 07/2024.

Bashkëngjitur ka prezantuar provën që dëshmon për shkeljen e tille ne ditën e zgjedhjeve në mërgate që ka qenë data 8 shkurt 2025.

Sipas parashtruesve të ankesave Subjekti Politik me këto veprime ka bërë shkeljen e rregullave zgjedhore, Bërja e fushatës në çfarëdo mënyrë, pas hapjes së qendrave të votimit, respektivisht pas orës 07:00/h.

Në përgjigjet në ankesa Subjekti Politik LVV, ka theksuar se pretendimet ankimore se më datë 7 shkurt 2025, gjatë procesit të votimit në vendvotimin ch 03/02, në Shtetin e Zvicrës (votimi i diasporës), kinse aktivistë të LVV janë paraqitur në vendvotimin përkatës më bluzë me mbishkrimin "Lëvizja Vetëvendosje", i cili fakt sipas pretenduesve, ka ndikuar qëllimisht të votuesit tjerë, Subjekti Politik LVV, i konsideron të pabazuara. Më tej theksohet se e njëjta, në asnjë moment, nuk përmban ndonjë fakt dhe provë të cilat do ta ndërlidhnin personin në fjalë si pjesë të LVV, përfshirë ndërlidhjen e shkeljes së pretenduar e cila sipas tyre, do të binte ndesh me nenin 37 të LZP-së. Ashtu siç vërehet edhe nga shkresat e ankesës në fjalë të paraqitura nga pretenduesi, nuk ekziston asnjë fakt i cili personin/votuesen në fjalë do ta ndërlidhte si pjesë të LVV. Për më shumë, konsiderojnë se përgjegjësia për mbarëvajtjen e procesit të Votimit në Qendrën përkatëse, përfshirë mos-lejmin e prezencës së votuesve me mbishkrimet e tilla, bie mbi menaxherin e Qendrës së Votimit.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimt dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.478/2025 dhe Anr486/2025 të datës 09.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.478/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga dy subjekte politike kundër subjektit të njëjtë politik LVV për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LVV, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik PDK dhe Subjekti Politik LDK, janë të bazuara dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet .”Nga hapja e Qendrave të

Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit;

Në përgjigje të ankesës, ku kundërshtohet pretendimi ankimor, se gjatë procesit të votimit në vendvotimin ch 03/02, në Shtetin e Zvicrës, aktivistë të LVV janë paraqitur në vendvotimin me materiale zgjedhore. Megjithatë, duke u bazuar në provat e paraqitura, paneli ka vlerësuar se nga mbështetësit/vëzhguesit e Subjektit Politik LVV në Zurich, në ditën e votimit, në konsullatën e Zurichut, kanë bartur material zgjedhor me emër të subjektit të tyre politik, si dhe kanë qenë të veshur me bluzë me mbishkrimin "LËVIZJA VETËVENDOSJE", duke ndikuar qëllimisht tek votuesit.

Paneli ka konsideruar këtë veprim si shkelje të nenit 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi veprimi është bërë në vendvotime e që ka për qëllim ndikimin tek votuesit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se veprimi i përshkruar në ankesat e parashtuara është në kundërshtim me dispozitat e nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit NR.08/L-228 dhe nenit 8 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores zgjedhore 07/2024, po ashtu fakti Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë ditës së votimit, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesa nga parashtuesit e ankesave paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtat i pranoi si të bazuara.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e lehte të shkeljes si dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LVV ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të votimit.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa
Anr.478/2025 më datën 11.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në kuptim të nenit 118.4 të LZP-së.